



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.634/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova-kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja VETVËNDOSJE!, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi i KQZ-së numër 01687-2025 për mosmiratimin e rekomandimit për hapjen e të gjitha kutive të votimit për fletëvotimet e dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ-së, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.03.2025, merr këtë,

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.634/2025 e datës 07.03.2025 e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja VETVËNDOSJE!, me seli në Prishtinë.

ANULOHET Vendimi i KQZ-së, numër 01687-2025, datë 06.03.2025, URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), sipas rekomandimit të Sekretariatit të KQZ të datës 06.03.2025, të bëjë hapjen e 177 kutive të votimit, me 1631 fletëvotime të pavlefshme, të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ-së, të njëjtat fletëvotime të rivlerësohen, të numërohen dhe të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.03.2025, ka pranuar ankesë Anr.634/2025 nga Subjekti Politik Lëvizja VETVËNDOSJE!, me seli në Komuna Prishtinë në të cilën pretendohet se më datë 6 mars 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, ka marrë vendim më anë të cilit refuzohet rekomandimi

i Sekretariatit të KQZ-së për hapjen e të gjitha kutive të votimit për fletëvotimet me postë të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ së.

Në arsyetimin e këtij vendimi, theksohet se KQZ nuk ka miratuar rekomandimin e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-SKQZ-së, që të marrë vendim për hapjen e të gjitha kutive të votimit përmes postes, me qëllim që të ri vlerësohen dhe të rinumërohen të gjitha fletëvotimet që janë shpallur të pavlefshme në përputhje me vendimin e PZAP-së, që votat e printuara që nuk janë printuar në tërësi të plota, por që vullneti i votuesit është i qartë, ku të njëjtat pastaj do të hyjnë për subjektet politike dhe për kandidatët.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar më datë 08.03.2025, theksohet se në mbledhjen e mbajtur me numër 17/ 2025 të datës 06.03.2025, nuk është miratuar rekomandimin e Sekretariatit të KQZ për hapjen e të gjitha kutive të votimit me fletëvotimet e dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ. Për më shumë, në këtë mbledhje kryesuesi dhe 3 anëtar kanë votuar për rekomandimin, ndërsa tre anëtarët tjerë kanë abstenuar.

Më tej në përgjigje theksohet se Sekretariati i KQZ-së, përmes rekomandimit ka kërkuar nga KQZ që të hapen 177 kutitë e votimit nga 187 gjithsejtë. Në këto 177 kuti të votimit, sipas tabulimit të statistikave, ekzistojnë 1,631 fletëvotime të pavlefshme, të zbrazëta dhe të pa plotësuara, dhe kur është fjala për fletëvotimet e pavlefshme të njëjtat mund të jenë të ngjashme apo të njëjta me fletëvotimet të cilat me vendimin e PZAP me numër Anr.623/ 2025, të datës 04.03.2025, janë shpallur të vlefshme për këto vendvotime: VP/0104, VP/0207, VP/0205 VP/0106, VP/0410, VP/0804t VP/0503, VP/0501, VP/0410, VP/0703, ku për të gjitha kutitë më lartë, PZAP e ka urdhëruar KQZ që fletëvotimet të vlerësohen të vlefshme dhe të njëjtat të përfshihen në rezultatin përfundimtar. E po ashtu, mund të ketë fletëvotime të pavlefshme, të cilat janë shpallur si të tilla, sipas procedurave, e të cilat nuk duhet të vlerësohen si të vlefshme. Po ashtu sikurse në përgjigjen e dërguar nga KQZ që lidhet me ankesën numër 623/2025 për të cilin PZAP ka marrë vendim me datën 04.03.2025, KQZ nuk ka udhëzuar votuesit për shtypjen e fletëvotimit në tërësi, edhe për fletëvotimet në kutitë tjera të votimit, rastet janë të njëjta.

Kjo dëshmohet edhe me marrjen e fotografive në QNR nga komisioni PZAP, i cili për kutitë e votimit të lartpërmendura (sipas ankesës Anr.623/2025) brenda kutive ka pasur më shumë se një ose dy fletëvotime të ngjashme ku nuk janë shtypur subjekti politik i fundit ose i parafundit, megjithëse vullneti i votuesit ka qenë qartë, siç përcaktohet me Rregulloren Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit (paragrafi 2 i nenit 16).

Si shtojcë në përgjigje KQZ, ka bashkangjitur listën me vendvotimet dhe për secilin numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, të pa plotësuara dhe të pa përdorura.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se Sekretariati i KQZ-së me datë 06.03.2025, i ka rekomanduar KQZ-së, që të marrë vendim për hapjen e të gjitha kutive të votimit për mes postës, me qëllim që të ri vlerësohen dhe të numërohen të gjitha fletëvotimet që janë shpallë të pavlefshme, në përputhje me vendimin e PZAP.

KQZ në mbledhjen e mbajtur me numër 17/ 2025 të datës 06.03.2025 ka marr vendim me të cilin nuk e ka miratuar rekomandimin e Sekretariatit të KQZ për hapjen e të gjitha kutive të votimit me fletëvotimet e dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ. Kundër këtij vendimi ankesë në PZAP ka paraqitur subjekti politik Lëvizja VETVËNDOSJE!, me seli në Prishtinë, ku ndër të tjera ka theksuar se një vendim i tillë cenon edhe vetë vendimin e PZAP A.nr.623/2025, i cili vendim ka paraparë që fletëvotimet të cilat nuk janë të printuara të plota/tërësi, të shpallen si të vlefshme, duke kërkuar që të urdhërohet KQZ që të rinumëroj, rivlerësoj të gjitha fletëvotimet e pavlefshme të dërguara me postë sipas rekomandimit të SKQZ-së.

Paneli vlerësoi se në lidhje me çështjen e vlefshmërisë së votave që përmbajnë gabim teknikë me shtypje-printim tashmë është marr vendim nga PZAP me numër A.nr.623/2025 datë 04.03.2025, ku është konstatuar se janë të vlefshme fletëvotimet në të cilat shprehet qartë qëllimi i votuesve se për cilin subjekt kanë votuar dhe shtypja – printimi jo i plotë nuk mund ta cenojë të drejtën e votuesve për të shprehur vullnetin e tyre.


Sekretariati i KQZ-së me datë 06.03.2025 ka nxjerr rekomandimin që KQZ të bëjë rinumërimin dhe hapjen e të gjitha kutive të votimit për fletëvotimet e dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ-së. Në rrethana të tilla ku PZAP tashmë ka vendim në lidhje fletëvotime që janë shpallë të pavlefshme nga ana e KQZ-së, në respektim të të drejtës së votës së çdo qytetari është vlerësuar se në këtë rast duhet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), sipas rekomandimit të Sekretariatit të KQZ të datës 06.03.2025, të bëjë hapjen e 177 kutive të votimit, me 1631 fletëvotime të pavlefshme, të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës në kutitë postare të KQZ-së, të njëjtat fletëvotime të rivlerësohen, të numërohen dhe të përfshihen në rezultatin përfundimtar, ashtu siç është përcaktuar me vendimin e PZAP-it A.nr.623/2025 datë 04.03.2025.

Në rinumërim KQZ, përkatësisht QNR në vlerësimin e fletëvotimeve të tilla ta ketë për bazë nenin 16 par.3 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, me të cilën konstatohet se votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.634/2025 më datën 09.03.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.